



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Këshilli Kombëtar i Integrimit European

RAPORTI VJETOR I KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EUROPIAN 2023

PËRMBAJTJA:

- I. KËSHILLI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EUROPIAN, ROLI DHE QËLLIMI**
- II. MONITORIMI I ZBATIMIT TË DETYRIMEVE TË PROCESIT TË INTEGRIMIT**
- III. RRITJA DHE FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE PËR ÇËSHTJET E INTEGRIMIT EUROPIAN**
- IV. BASHKËPUNIMI I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN ME SHOQËRINË CIVILE, MEDIAN DHE GRUPET E INTERESIT**
- V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**
- VI. ANEKS**

I. KËSHILLI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EUROPIAN, ROLI DHE QËLLIMI

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian (KKIE) është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin europian, e krijuar në bazë të Ligjit nr. 15/2015, datë 05.03.2015, “*Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian*”¹ të ndryshuar, si një instrument i rëndësishëm për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse lidhur me reformat integruese të vendit. Misioni e tij parësor është nxitja dhe garantimi i bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe sigurimi i rritjes së transparencës në vendimmarrjet për çështjet e integrimit. Përgjegjësitë kryesore të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian janë:

- nxitja e bashkëpunimit midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura dhe shoqërisë civile, në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian;
- sigurimi i diskutimit të vazhdueshëm për politikën e integrimit europian, të zbatuara nga institucionet shtetërore, me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar;
- monitorimi i zbatimit të detyrimeve për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian;
- analizimi i kuadrit ekzistues normativ dhe praktikave në lidhje me procesin e integrimit europian, për çështjet që merr në shqyrtim;
- sigurimi i bashkëpunimit të vazhdueshëm për procesin e integrimit me komisionet e përhershme parlamentare dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për integrimin europian; monitorimi i ecurisë së procesit të negociatave/bisedimeve për anëtarësim;
- këshillimi ose dhënia e opinionëve lidhur me procesin e negociatave;
- mbajtja e kontakteve dhe shkëmbimi i informacionit me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Kombëtar për Integrim Europian;
- zhvillimi i takimeve me drejtuesit e grupit negociator dhe drejtuesin e delegacionit shqiptar në negociatat/bisedimet për anëtarësim;
- raportimi të paktën një herë në vit në Kuvend mbi punën e Këshillit.

Duke zbatuar rolin të tij dhe në mbështetje të qëllimit për të cilin është krijuar, si garantues i dialogut gjithëpërfshirës, KKIE është fokusuar në promovimin e përfshirjes të të gjithë aktorëve

¹ https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji_15-2015-1.pdf

në procesin e integrimit europian. Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian është i bindur se roli i shoqërisë civile dhe të gjithë aktorëve në procesin e integrimit është mëse i domosdoshëm. Hapja e negociatave të anëtarësimit në BE përbën një sfidë të vazhdueshme në punën gjithëpërfshirëse të KKIE. Ajo do të vijojë të forcojë në mënyrë të vazhdueshme bashkëpunimin me shoqërinë civile si dhe të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të saj, si një partner shumë i rëndësishëm në ecurinë e suksesshme të reformave të integrimit.

II. MONITORIMI I ZBATIMIT TË DETYRIMEVE TË PROCESIT TË INTEGRIMIT

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian, bazuar në misionin e tij gjithëpërfshirës si dhe në përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në Bashkimin Europian i ka kushtuar vëmendje të veçantë rolit të rëndësishëm që luan në drejtim të garantimit të bashkëpunimit jo vetëm ndërmjet forcave politike dhe institucioneve publike, por veçanërisht, bashkëpunimit me shoqërinë civile, botën akademike dhe të gjitha grupet e interesit të shoqërisë.

Forcimi i rolit të KKIE dhe garantimi i gjithëpërfshirjes në çështjet e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian është vlerësuar dhe në raportin vjetor të Komisionit Europian për Shqipërinë 2023.

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës si dhe sfidat integruese të vendit, KKIE i ka kushtuar veçanërisht vëmendje, nxitjes së dialogut konstruktiv dhe gjithëpërfshirës, përmirësimit të njohurive mbi procesin e integrimit europian të të gjithë grupeve të interesit dhe transparencës si domosdoshmëri integruese.

Këshillit Kombëtar i Integrimit Europian bazuar edhe në Planin e tij të Punës për vitin 2023, ka organizuar gjithsej 14 takime, nga të cilat 5 periodike dhe 9 ndërgjegjësuere, tematikat e të cilave i gjeni si më poshtë:

- ❖ ***ZBATIMI I PLANIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EUROPIAN, ECURIA NË PROCESIN E INTEGRIMIT DHE GRUP KAPITULLI 1***

Në datën **27 Janar 2023** u zhvillua takimi me temë *“Mbi hapat e deritanishëm në procesin e negociatave me Bashkimin European dhe diskutimin dhe miratimin e raportit vjetor të KKIE”*. Në takim mbajtën fjalë përshëndetëse Kryetarja e KKIE-së, Znj. Jorida Tabaku dhe Nënkryetari, Z. Taulant Balla, të cilët vlerësuan rolin qendror dhe kontributin që Kuvendi mund dhe duhet të japë në procesin e integritimit në BE. Në mbledhje mori pjesë Znj. Isabel Santos, anëtare dhe Raportuese për Shqipërinë në Parlamentin European, e cila ndau me pjesëmarrësit perspektivën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Gjatë fjalës së saj, Znj. Isabel Santos, nënvizoi rëndësinë që procesi i integritimit european duhet të jetë sa më transparent dhe gjithëpërfshirës për të qenë i suksesshëm. Ajo theksoi rëndësinë e vijimit të reformave dhe pasjen e një vizioni strategjik për rrugën që do të ndiqet në lidhje me integritimin european, por dhe një plan konkret për hapat që do të ndërmerren. Ndërkohë znj. Majlinda Dhuka, Ministre Shteti dhe Kryenegociatore e Shqipërisë me BE, raportoi lidhur me ecurinë e procesit të deritanishëm dhe takimet dyplëshe që janë zhvilluar me Komisionin European, lidhur me Grup Kapitullin 1. Ministre Dhuka, në fjalën e saj theksoi angazhimin e ndërmarrë për avancimin e agjendës së integritimit dhe se negociatat e anëtarësimit



në BE do të jenë një proces transformimi, një mundësi e shkëlqyer për transferimin e standardeve të BE-së në institucionet vendase, në tregun e brendshëm shqiptar dhe shoqërinë shqiptare.

Pas miratimit të raportit vjetor, takimi vijoi me diskutimet nga anëtarët dhe të ftuarit e KKIE-së ku fjalën e morën: Z. Enkelejd Alibeaj, Znj. Etilda Gjonaj, Znj.Klotilda Bushka dhe Z. Gledis Gjipali (EMA).

❖ *SHYRTIMI ANALITIK I LEGJISLACIONIT DHE PAVARËSIA E SISTEMIT GJYQËSOR*

Më **16 mars 2023**, u zhvillua takimin me temë “*Çfarë pritet nga Shqipëria gjatë procesit të negociatave me Bashkimin Europian?*” në të cilin mori pjesë SH.T.Z. Olivér Várhelyi, Komisioneri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin në Komisionin Europian. Të ftuar në takim ishin Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme, Znj. Olta Xhaçka, Ministër i Shtetit dhe Kryenegociatorja Znj.Majlinda Dhuka, Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Z .Alfred Balla, Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Z. Olsian Çela, Prokuror i Përgjithshëm, Z. Altin Dumani, Drejtues i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Komisioneri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin në BE, Z. Olivér Várhelyi theksoi rëndësinë e arritjes së konsensusit mes palëve dhe nënvizoi se të gjithë duhet të punojnë bashkërisht për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Duke theksuar se integrimi është një proces mjaft kompleks dhe transformues, ai vlerësoi rolin e KKIE-së dhe inkurajoi gjithkënd të ndihmojë dhe kontribuojë në këtë fazë në të cilën ka hyrë procesi, pas mbajtjes së Konferencës së parë Ndërqeveritare dhe çeljes zyrtarisht të bisedimeve për anëtarësim. Ai e vlerësoi si një proces transformues të ekonomisë dhe shoqërisë dhe u shpreh se KKIE dhe Kuvendi do të kenë një rol tejet të rëndësishëm në përafrimin e legjislacionit të BE, por dhe të zbatimit të tij në praktikë për të siguruar mundësi të reja për qytetarët dhe bizneset vendase, hyrjen në tregun europian apo tërheqjen e investitorëve të huaj që duan të investojnë në Shqipëri. Duke u ndalur në ato çfarë pritet nga Shqipëria në këtë proces, Komisioneri Várhelyi u shpreh se ka nisur tashmë një punë e konsiderueshme teknike që është shqyrtimi analitik i legjislacionit, çka do të përcaktojë më pas se kur do të mund të zbatohet legjislacioni i BE, por dhe duke u garantuar më parë ekzistenca e agjencive të duhura ligj zbatuese, burimet njerëzore e duhura, kapacitetet e nevojshme për të ekzekutuar rregullat në të njëjtën mënyrë si në BE. Mbledhja u përshëndet më pas nga Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Znj.Olta Xhaçka, e cila informoi mbi takimin e 12-të të Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe u shpreh se Shqipëria vijon të tregojë përkushtim në rrugën drejt BE dhe procesit të transformimit. Në takim mori fjalën Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, i cili parashtrroi se lufta ndaj

korrupsionit në gjyqësor apo lufta për pavarësinë e sistemit gjyqësor nuk është një destinacion përfundimtar, por është një përpjekje e përditshme jo vetëm e strukturës që punon për të ngritur dhe bërë funksional sistemin e kontrollit kushtetues dhe demokratik të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, por e të gjithë aktorëve të shoqërisë. Më pas, Z. Altin Dumani, Drejtuesi i SPAK u shpreh se prokurorët e SPAK ushtrojnë me përkushtim detyrën e tyre sa i takon goditjeve të veprave penale, por institucioni ka nevojë të forcojë bashkëpunimin për të pasur rezultate sa më të mira. Në takim diskutuan anëtarët e KKIE-së: Z. Enkelejd Alibeaj dhe Znj. Etilda Gjonaj.



❖ PROCESI I BERLINIT DHE SFIDAT INTEGRUESE TE SHQIPËRISË

Në **3 Prill 2023** u organizua takimi i radhës me fokus të veçantë “*Ecuria e Procesit të Berlinit, sfidat dhe arritjet e deritanishme të Shqipërisë*”. Të ftuar për të referuar ishin Znj. Majlinda Bregu, Sekretare e Përgjithshme e Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal, Znj. Belinda Balluku, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Z. Albert Hani, Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor. Znj. Majlinda Bregu, Sekretare e Përgjithshme e Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal fillimisht vlerësoi rolin e KKIE

në procesin e integrimit dhe mbikëqyrjes mbi masat që janë marrë e do të ndërmerren në të ardhmen nga qeveria, e në mënyrë të veçantë u ndal në faktin se Shqipëria në tetor të këtij viti do të drejtojë Samitin e Procesit të Berlinit, duke u bërë samiti i dytë që zhvillohet në Tiranë, në një hark kohor të shkurtër. Ajo u ndal tek agjenda e bashkëpunimit rajonal, duke shpjeguar më tej hapat e ndërmarra për krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal të bazuar në 4 shtylla kryesore: tregti, digjitale, investime dhe inovacion e turizëm. Znj. Bregu sqaroi më tej se Shqipëria ishte e para që ratifikoi 3 marrëveshje të Procesit të Berlinit dhe u ndal në mënyrë të veçantë tek rëndësia e zbatimit të marrëveshjeve të lëvizjes së lirë, Agjendën e Gjellbër, por dhe Marrëveshjen Roaming midis vendeve të BP me ato të BE-së, për uljen e tarifave roaming, të cilën e vlerësoi si histori suksesi. Më pas Znj. Belinda Balluku, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u përqendrua tek ecuria dhe sfidat e Shqipërisë në Procesin e Berlinit duke u ndalur tek agjenda e konektivitetit, detyrimet që rrjedhin në kuadër të Procesit të Berlinit, integrimit të tregjeve, ndryshimeve ekologjike, etj. Ajo renditi disa arritje të shënuara në fushën e transportit, energjisë, krijimin e një zone ekonomike rajonale, forumet e dhomave të tregtisë dhe industrisë, komunitetin e transportit, liberalizimin e pjesëshëm të tregut të energjisë elektrike, krijimin e Bursës Shqiptare, etj. Z. Albert Hani, Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), bëri një përmbledhje të arritjeve dhe sfidave të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor. Ai u ndal në disa prej prioriteteve të punës në të ardhmen si: realizimin e programeve të shkëmbimit mes të rinjve; edukimin kulturor; krijimit të mundësive për profesionistët e rinj; fuqizimin e organizatave studentore; ngritjen e kapaciteteve për organizatat e shoqërisë civile; etj. Në takim diskutuan dhe ngritën pyetje anëtarë dhe të ftuar të KKIE-së: Znj. Flutura Açka, Z. Fatmir Mediu, Z. Eduard Shalsi, Znj. Dafina Hysa.

❖ *E CURIA E PROCESIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE HAPAT NË VIJIM*

Më **19 korrik 2023**, KKIE zhvilloi takimin me temë: *“Ecuria e procesit të integrimit europian dhe hapat në vijim”*, gjatë së cilit u diskutua mbi ecurinë e procesit të integrimit europian dhe hapat që po ndiqen në vijim në këtë proces. Në këtë takim mori pjesë Sh.S. Znj. Christiane Hohmann, Ambasadore e Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri, që ndau me pjesëmarrësit perspektivën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe Znj. Olta Xhaçka, Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme, e cila foli mbi masat e marra nga Shqipëria për përshejtimin e

procesit integruar të vendit. Në takim mbajtën fjalë përshëndetëse Kryetarja e KKIE-së, Znj. Jorida Tabaku, Z. Toni Gogu, në cilësinë e Nënkryetarit të KKIE dhe Kryetare e Kuvendit Znj. Lindita Nikolla, të cilët vlerësuan rolin qendror dhe kontributin që Kuvendi mund të japë në procesin e integritimit në BE.



Znj. Nikolla, vlerësoi se lidhshipia e Kuvendit në procesin e integritimit dhe roli i tij si garantues i legjitimitetit demokratik dhe tiparit gjithëpërfshirës të procesit të integritimit është jetësuar nëpërmjet kontributit të dukshëm dhe të vlerësuar të Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian, si edhe të Komisionit për Çështjet Europiane.

Kryetarja e KKIE, Znj. Jorida Tabaku fillimisht vlerësoi rritjen e përfaqësimit të shoqërisë civile pas miratimit të ligjit të ri dhe nënvizoi faktin që një vit pas hapjes së negociatave dhe përfundimit të procesit “screening” ende shkëmbimi i informacionit me qeverinë nuk është maksimal. Duke vlerësuar punën e institucioneve të reja të drejtësisë, nënvizoi rëndësinë e luftës ndaj korrupsionit dhe forcimin e pavarësisë së institucioneve. Zëvendëskryetari i Këshillit Kombëtar për Integritimin Europian, Z. Toni Gogu, vlerësoi punën dhe hapat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare në

procesin e negociatave me Bashkimin European, ndërsa vlerësoi edhe dialogun konstruktiv me opozitën për këtë çështje. Duke nënvizuar faktin se takimi përkon me njëvjetorin e hapjes zyrtarisht të negociatave me BE-në, Z. Gogu vlerësoi se Shqipëria ka ecur mirë drejt procesit integruar. Duke vlerësuar punën profesionale të ekipeve negociuese dhe delegacioneve shqiptare gjatë procesit “screening”, Z. Gogu vlerësoi bashkëpunimin me delegacionin e BE-së në Tiranë. Gjatë fjalës së saj, Ambasadorja e Bashkimit Evropian në Tiranë, Sh.Z. Christiane Hohmann bëri një përmbledhje të punës së bërë në një vit që nga momenti i nisjes zyrtarisht të negociatave, procesit “screening” për grupin e kapitujve të parë, si dhe vlerësoi punën e bërë nga grupet negociatore në një kohë relativisht të shpejtë.

❖ *ECURIA E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KOMISIONIT EUROPIAN TË RAPORTIT TË VITIT 2022 NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT E KRIMIT TË ORGANIZUAR*

Duke rikujtuar Samitin e 6 Dhjetorit, Ambasadorja vlerësoi se imazhi i Shqipërisë ka ndryshuar, por në të njëjtën kohë inkurajoi vijimin e punës në drejtim të zbatimit dhe ndërmarrjen e reformave. “Suksesi i Reformës në Drejtësi bëri që Shqipëria të fitonte një vend në tavolinën e negociatave. Duke vlerësuar më tej rezultatet e arritura nga SPAK-u përgjatë vitit të fundit, ajo nënvizoi rëndësinë e mbështetjes së gjyqësorit nga Kuvendi, duke kërkuar që secili prej aktorëve të garantojnë që gjyqësori të japë rezultatet në standardet më të larta europiane dhe të mos ketë dyshime apo pikëpyetje në dhënien e drejtësisë për qytetarët. Ministrja për Europën dhe Punët e Jashtme, Znj. Olta Xhaçka, vlerësoi se Shqipëria po përjeton një rienergizim të procesit të integritetit dhe një vëmendje të re të institucioneve europiane, e shoqëruar me arritje të qenësishme, të prekshme për të gjithë. Në takim diskutuan mbi procesin e integritetit anëtarët e KKIE-së: Z. Ferdinand Xhaferraj, Znj. Etilda Gjonaj dhe Znj. Erisa Xhixho.

Më 18 Tetor 2023 u zhvillua takimi i radhës me temë: “Ecuria në luftën kundër korrupsionit dhe zbatimi i rekomandimeve të Komisionit European në Raportin e vitit 2022 për Shqipërinë si dhe Nënkomitetit BE-Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2023”, çështje për të cilën ishin thirrur për të informuar anëtarët dhe të ftuarit e KKIE që ishin Z. Altin Dumani, Drejtues i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Znj. Adea Pirdeni, Zëvendësministër i Ministrisë së Drejtësisë. Kryetarja dhe Nënkryetari i KKIE vlerësuan rëndësinë e tryezave të tilla

raportuese për të adresuar çështje thelbësore dhe monitoruar luftën kundër korrupsionit. Drejtuesi i SPAK-ut parashtroi se për të arritur rezultate të mira në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nevojiten 3 shtylla kryesore si: legjislacioni i mirë; pasja e burimeve njerëzore dhe koordinimi me agjencitë ligjzbatuese.



Ai informoi dhe për punën e bërë për plotësimin e organikës së SPAK, emërimin e 12 hetuesve financiarë dhe BKH dhe se ka nënshkruar një Marrëveshje Punë me Prokurorin Publik Europian në korrik 2023, ku po punohet që këto lloj marrëveshjesh të shtrihen edhe me vende të tjera, në të cilat dyshohet se ka aktivitetet të pastrimit të produkteve penale. Duke iu referuar vizitës të Reporterëve të Këshillit të Europës (KE) në SPAK, në shtator 2023, nënvizoi se reporterët vlerësuan rezultatet e prekshme të SPAK në luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve të lartë, megjithatë u kërkua që SPAK-ut t'i sigurohen burimet e nevojshme për të ushtruar me efikasitet funksionin e tij, por dhe ndryshimi i kufirit monetar të rasteve të korrupsionit që i referoheshin SPAK-ut, çka ndikon në ngarkesën e punës së prokurorëve dhe zhvendosjen e prioriteteve të tij

nga hetimi i korrupsionit të niveli të lartë. Më pas, Znj.Adea Pirdeni, u shpreh se agjenda antikorrupsion zbatuar nga Qeveria shqiptare ka qenë pashmangshmërisht e lidhur me ecurinë e procesit të negociatave me BE-në, çka u dëshmuo edhe gjatë takimeve të procesit “screening”. Duke iu referuar raportit të fundit, ajo u shpreh se KE ka vlerësuar se zbatimi i Strategjisë Ndërsektorale Antikorrupsion është në rrugën e duhur, duke u përqendruar tek reforma e shërbimeve dixhitale, ku ofrohen 750 shërbime më shumë nga sa ishin parashikuar në Strategji. Duke iu referuar punës së bërë me procesin e hartëzimit të të gjithë proceseve që mbartin risk korrupsioni, Znj.Pirdeni vlerësoi bashkëpunimin e mirë të arritur me shoqërinë civile. Sipas saj: “Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion dhe Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit që nga fillimi i punës e deri në muajin Shtator 2023, ka kryer një numër të konsiderueshëm hetimesh administrative me objekt verifikimin e praktikave abuzive/ arbitrare apo denoncimeve të ndryshme lidhur me raste të dyshuara për korrupsion”. Në takim diskutuan dhe drejtuan pyetje lidhur me rezultatet konkrete të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit anëtarët dhe të ftuarit e KKIE-së: Z. Ferdinand Xhaferaj, Znj.Etilda Gjonaj, Znj.Klotilda Bushka, Znj. Erinda Skëndaj dhe Z. Agim Rrapaj.

TAKIME NDËRGJEGJËSUESE

Në datën **17 Shkurt 2023**, KKIE zhvilloi një takim ndërgjegjësues “*Për rolin që luan Kuvendi i Shqipërisë në procesin e integritit europian*”, në të cilën morën pjesë të rinj nga Akademia e Integritit European dhe Negociatave - AIEN. Diskutimi u përqendrua në rolin e Kuvendit dhe KKIE-së, jo vetëm në forcimin e rolit mbikëqyrës dhe kontrollues mbi qeverinë në hapat e ndërmarra në procesin e integritit, por dhe në nevojën e rritjes së përfshirjes qytetare dhe transparencës nga qeveria, tashmë që negociatat me BE janë hapur zyrtarisht. Takimi u përshëndet nga Znj.Jorida Tabaku, Kryetare e KKIE dhe Znj. Mona Xhexhaj, Drejtore Ekzekutive e AIEN, të cilat në fjalën e tyre theksuan rëndësinë e përfshirjes sa më shumë të të rinjve në proces, duke i inkurajuar pjesëmarrësit të jenë sa më aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për vlerat europiane. Znj.Tabaku i njohu pjesëmarrësit me draft-ndryshimet ligjore që priteshin të miratoheshin brenda muajit Shkurt, për rolin që do të ketë Kuvendi në këtë fazë të procesit dhe nënvizoi nevojën për përthithjen e sa më shumë të rinjve dhe rritjen e kapaciteteve, për të fituar kohën e humbur në procesin e integritit.

Duke e konsideruar si domosdoshmëri shndërrimin e procesit në një debat kombëtar, ajo theksoi rëndësinë e përfshirjes në diskutime të sindikatave, shoqatave të biznesit, dhomave të tregtisë, por dhe qytetarët, për të kuptuar qartë përfitimet dhe kostot që do të sjellin reformat integruese. Më pas Znj. Tabaku i njohu pjesëmarrësit me hapat e ndërmarra nga KKIE, takimet e organizuara në disa universitete të vendit për rritjen e ndërgjegjësimit dhe iu përgjigj pyetjeve të tyre mbi sfidat që paraqet përthithja e fondeve IPA, rolin e qeverisë dhe Kuvendit përgjatë diskutimeve për Cluster 2, që përfshin tregun e brendshëm, lëvizjen e lirë të mallrave, etj. Takimi vijoi me prezantimin e Znj. Elda Zenelaj, Drejtore e Sekretariatit Teknik të KKIE, e cila i njohu pjesëmarrësit me strukturat përgjegjëse për integrimin, rolin e deritanishëm të Kuvendit në procesin e integritit dhe ndryshimet që parashikohet të sjellin ndryshimet ligjore për forcimin e rolit të Kuvendit, etj.

Më **24 Mars 2023**, KKIE dhe European Movement Albania (EMA), në bashkëpunim me Slovak Foreign Policy Association, me mbështetjen financiare të SlovakAid, organizuan *Sesionin Plenar të Konventës Kombëtare për Integrimin European 2021- 2023*. Aktiviteti u organizua në dy pjesë dhe në panelin e parë përshëndeti Znj. Jorida Tabaku, Kryetare e KKIE, Znj. Etilda Gjonaj, Nënkyetare e Komisionit për Integrimin European, Z. Gledis Gjipali, Drejtor ekzekutiv i Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Z. Tomas Strazay, Drejtor i Research Center of Slovak Foreign Policy Association (RC SFPA). Znj. Tabaku në fjalën e saj fillimisht vlerësoi përfshirjen e shoqërisë civile dhe EMA në mënyrë të posaçme, në diskutimin lidhur me procesin e integritit, por dhe grup kapitujve që janë duke u shqyrtuar në Bruksel në funksion të procesit “screening”. Ajo nënvizoi se secili nga aktorët duhet të garantojë që procesi të jetë sa më i prekshëm nga qytetarët. Znj. Etilda Gjonaj, Zëvendëskryetare e Komisionit të Integritit European, duke e cilësuar procesin e integritit si destinacionin pëfundimtar që kërkohet dhe meritojnë qytetarët, vlerësoi se Shqipëria ka ardhur nga një proces sfidues dhe ka arritur përparime të qenësishme në fusha si mirëqeverisja apo sundimi i ligjit, forcimi ekonomik, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Z. Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv i Lëvizja Europiane në Shqipëri në fjalën e tij vlerësoi bashkëpunimin e mirë ndër vite me KKIE për trajtimin e çështjeve të veçanta dhe të ndjeshme për shoqërinë shqiptare dhe rrugën transformuese që do të sjellë procesi. Z. Tomas Strazay, Drejtor i Research Center of Slovak Foreign Policy Association (RC SFPA) bëri një

përmbledhje të bashkëpunimit me partnerët vendorë, dhe vlerësoi progresin e bërë në përgatitjet për procesin e negocimit dhe forcimin e kapaciteteve në sektorë të ndryshëm. Pas fjalëve përshëndetëse, të pranishmit në takim ndanë vlerësimet dhe sugjerimet e tyre për forcimin e rolit të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në çështje të një rëndësie të veçantë, si: bujqësia, të drejtat e konsumatorit, sigurisë ushqimore, dhe në procesin negociues.



Në pjesën e dytë të takimit, Znj. Elona Bano, Drejtor, Drejtorja e Integritit dhe Negociatave, Ministria e Drejtësisë, Znj. Suela Jahaj, Drejtor, Drejtorja e Integritit, Marrëveshjeve, Koordinimit dhe Asistencës, Ministria e Brendshme, Z. Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar dhe Znj. Flutura Xhabija, Presidente e Shoqatës së Grave Profesioniste, Afariste e Zejtare të Shqipërisë, ndanë eksperiencën e bashkëpunimit mes institucioneve dhe shoqërisë civile, sfidat dhe progresin e bërë në procesin e integritit sipas 4 grup kapitujve që janë në proces shqyrtimi nga BE. Konventa u përqendrua në 3 drejtime kryesore: 1) Rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin vendor); 2) Institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) Forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në datën **8 Qershor 2023**, Sekretariatit Teknik të KKIE organizoi në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike një sesion informues (on line) me 60 nëpunës të administratës qendrore dhe vendore, për rolin që luan Kuvendi i Shqipërisë dhe KKIE në procesin e integritit europian”.

Në 17 Qershor 2023 u organizua nga Sekretariati teknik i KKIE në bashkëpunim me Akademinë e Konsumatorit, një takim ndërgjegjësues me 28 studentë të Akademisë së Konsumatorit, të cilët u njohën mbi rolin që luan KKIE dhe specifikisht OSHC-të si pjesë e KKIE në procesin e integritit europian”.

Në 19 Shtator 2023 u organizua një takim ndërgjegjësues i KKIE mbi procesin e negociatave me Bashkimin Europian, në të cilën morën pjesë përfaqësi grupesh interesi të ardhur nga Gjermania mes të cilëve përfaqësues nga sindikatat, biznesi, organizatat e shoqërisë civile, ish-punonjës të administratës në ekzekutiv dhe parlament etj. Të ftuarit u pritën nga Znj. Jorida Tabaku, e cila pasi u uroi mirëseardhjen, bisedoi me ta lidhur me rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e negociatave me BE.

Sekretariati teknik i KKIE në bashkëpunim me Institutin Parlamentar zhvilloi në datën **3 Tetor 2023**, pranë sallës së seancës plenare, një takim ndërgjegjësues mbi procesin e integritit europian dhe rolin të Kuvendit dhe KKIE në procesin e integritit, në të cilin morën pjesë 60 studentë dhe pedagogë nga Univeristeti i Danimarkës.

Sekretariati teknik i KKIE në bashkëpunim me Institutin Parlamentar dhe KAS Shqipëri zhvilloi në datën **18 Tetor 2023**, një takim ndërgjegjësues mbi procesin e negociatave, rolin të Kuvendit dhe KKIE-së me 35 shtetas francezë (ish deputetë, kërkues shkencor, përfaqësues të OSHC-ve, sindikatave) etj.

Sekretariati teknik i KKIE në bashkëpunim me EU Policy Hub zhvilloi në datën **11 Nëntor 2023**, në Korçë, një takim ndërgjegjësues me 26 përfaqësues nga OSHC, pedagogë e studentë dhe nëpunës të qeverisjes vendore mbi procesin e integritit europian dhe rolin të KKIE, risitë e ndryshimeve të ligjit 15/2015 si dhe statusit të deritanishëm referuar procesit të shqyrtimit analitik sa i takon kontributeve të Kuvendit në kapitullin 23, kriterin politik, reformën në administratën publike, kapitullin 10 dhe 32.

KKIE në bashkëpunim me Akademinë e Integritit European dhe Negociatave – AIEN, organizoi në datë **12 Dhjetor 2023** takimim ndërgjegjësues me temë: *“Roli i Këshillit Kombëtar të Integritit European në procesin e integritit evropian”* si dhe *“Risitë e ndryshimit të Ligjit 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit në Bashkimin European”*”. Të ftuarit u pritën nga Znj. Jorida Tabaku, e cila bashkëbisedoi me ta lidhur me rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integritit në BE, fazën në të cilën ndodhet procesi i negociatave në prag të Samitit të Këshillit European me Ballkanin Perëndimor dhe theksoi nevojën që procesi të mos vlerësohet thjesht ligjor, por të shërbejë si ndryshim mendësie dhe të jetë sa më transparent dhe gjithëpërfshirës. Pjesëmarrësit u njohën më pas nga Znj. Elda Zenelaj, Drejtore e Sekretariatit Teknik të KKIE mbi rolin e KKIE dhe ndryshimet që ka sjellë zbatimi i ligjit të ri për forcimin e rolit të Kuvendit, detyrimet për raportimin e ecurisë së procesit, rolin e OSHC-ve pjesë e KKIE, etj.

III. RITJA DHE FORCIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE PËR ÇËSHTJET E INTEGRIMIT EUROPIAN

Rritja e kapaciteteve për çështjet e integritit evropian, konsiderohet sfidë e gjithë shoqërisë dhe kërkon profesionistë të aftë për t’u ballafaquar me procesin e integritit. Tradita e suksesshme e organizimit të Shkollës së Integritit European, e krijuar ndër vite nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Integritit European vazhdoi dhe në vitin 2023. Këshilli Kombëtar i Integritit European në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit European, Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Fondacionin Friedrich Ebert dhe Western Balkans Consulting, organizoi Shkollën e Integritit European në datat 6-10 Nëntor 2023. Për të tetin vit radhazi, Shkolla e Integritit European synoi të identifikojë dhe angazhojë aktorë nga të gjitha institucionet qendrore dhe ato të pushtetit vendor, organizatat e shoqërisë civile, media, minoritetet dhe grupet e interesit, duke krijuar një grup të spikatur ekspertësh me njohuri të thella mbi procesin e integritit evropian, të cilët mund të kontribuojnë në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Shkolla e Integritit European 2023, ofroi një kuadër të plotë teorik dhe praktik mbi zhvillimet më të fundit në BE, skenarët e mundshëm për të ardhmen e tij, sfidat dhe strategjitë e negociatave, rolin e shoqërisë civile dhe medias në proces, ecurinë e procesit të integritit të vendit, si dhe të ardhmen e procesit të zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë. Lektorë nga Komisioni European, Universiteti i Selanikut, ekspertë ndërkombëtarë nga Brukseli, Gjermania dhe vendet e rajonit si

Serbia dhe Mali i Zi, si dhe ekspertë kombëtarë nga institucione, përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile, ndanë eksperiencën e tyre profesionale në çështjet e integrimit.

Programi përfshiu tema të rëndësishme rreth procesit të integrimit evropian si:


- Sfidat dhe strategjitë e anëtarësimit, kapitulli 23;
- Zbatimi i legjislacionit të BE-së në gjykata;
- Roli i medias dhe shoqërisë civile në procesin e integrimit;
- Roli i pushtetit vendor në procesin e integrimit evropian;
- Financimet e BE-së gjatë fazës së negociatave të Shqipërisë etj.

Komisioni u përball me një numër të madh aplikimesh (106), i cili duke u bazuar në një përzgjedhje transparente dhe duke marrë parasysh përfaqësimin e të gjitha grupeve të interesit dhe aktorëve të procesit të integrimit, përzgjodhi 38 pjesëmarrës, të cilët u bënë pjesë e SHIE. Për herë të parë, këtij eventi i janë bashkuar on-line edhe 12 ekspertë shqipfolës nga vendet e rajonit, të cilët janë student të Shkollës së Diplomacisë Bruksel. Konkretisht:

- 5 përfaqësues nga Organizatat e Shoqërisë Civile
- 1 përfaqësues nga bashkimet profesionale;
- 2 përfaqësues nga biznesi;
- 5 lektorë dhe kërkues shkencor;
- 17 përfaqësues nga institucionet qendrore dhe të pavarura etj;
- 2 përfaqësues nga media;
- 4 përfaqësues nga bashkitë;
- 2 përfaqësues nga grupet parlamentare;

- 12 përfaqësues nga Shkolla e Diplomacisë në Bruksel.

Gjatë vitit 2023, u trajnuan në total 50 përfaqësues, ose 12-më shumë sesa gjatë vitit 2022.



Theksojmë se gjatë periudhës 2016-2023 janë trajnuar rreth 317 përfaqësues nga të gjitha grupet e interesit, të cilët janë kontribues potencialë në procesin e integrimit evropian të vendit.

IV. BASHKËPUNIMI I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN ME SHOQËRINË CIVILE, MEDIAN DHE GRUPET E INTERESIT

Me ndryshimin e ligjit nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” u shfuqizua detyrimi për të përfshirë vetëm 3 OSHC për çdo kapitull dhe u la e hapur pjesëmarrja dhe përfshirja për të gjithë aktorët e shoqërisë civile të cilët do i përgjigjen thirrjes për aplikim për çdo grup-kapitull duke synuar kështu jo vetëm rritjen e gjithëpërfshirjes por dhe nivelit të ekspertizës që duhet për ti bërë ballë procesit të monitorimit të negociatave dhe të gjithë dokumentave që ky Këshill do të monitoroj në këtë kuadër të këtij procesi. Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian, tashmë nuk është vetëm një platformë këshillimore që i përket vetëm Kuvendit por një platformë e hapur për çdo aktor të përfshirë në procesin e integrimit. Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe rritja në mënyrë të vazhdueshme të kapaciteteve të saj, kanë qënë dhe vazhdojnë të jenë ndër përparësitë kyçe të punës së KKIE duke u konkretizuar nëpërmjet instrumentave të ndryshëm si:

❖ Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere në bashkëpunim me OSHC dhe grupet e tjera të interesit

Gjatë zbatimit të planit vjetor të punës, janë organizuar 9 takime ndërgjegjësuere, në bashkëpunim me OSHC –të dhe grupet e tjera të interesit. Nxitja e dialogut mbi zbatimin dhe cilësinë e reformave janë vendimtare në forcimin e konsensusit gjithëpërfshirës. Për këtë arsye do të rriten përpjekjet për bashkëbisedim me shoqërinë civile, përmes organizimit të takimeve ndërgjegjësuere, forumeve dhe tryezave të rrumbullakëta të përqendruara në kapituj dhe politika prioritare të legjislacionit të BE, duke inkurajuar debatin konstruktiv mbi qasjen efektive të detyrimeve të parashikuara prej tyre.

❖ Anëtarësim i hapur për OSHC-të në KKIE

Më datë 26.05.2023, në faqen elektronike të Kuvendit është publikuar: “Thirrja për aplikimin e OSHC-ve për anëtarësim në Këshillin Kombëtar të Integritit European”. Pas përfundimit të afatit të parashikuar në thirrjen respektive, në datë 15.06.2023, rezultuan 16 aplikime nga shoqëria civile dhe të gjitha OSHC-të që aplikuan, u kualifikuan dhe u anëtarësuan në mandatin e ri.

❖ **Konsultimi i ndryshimeve ligjore të ligjit nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.**

Më datë 3.02.2023, Sekretariati Teknik i KKIE, ju ka dërguar elektronikisht për konsultim, projekt-ligjin e Komisionit të Posaçëm parlamentar për hartimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në Procesin e Integritit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian”, të hartuar me mbështetjen e ekspertëve kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo ishte një mundësi e mirë për përfaqësuesit e OSHC-ve por dhe grupeve tjera të interesit, për të kontribuar me sugjerimet e tyre në ndryshimet ligjore të një ligji kaq të rëndësishëm në fushën e integritit. Në përfundim të procesit të konsultimit, 3 OSHC dërguan komentet pranë sekretariatit teknik të KKIE (KSHH, OSFA dhe IDM).

❖ **Forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve**


Këshilli Kombëtar i Integritit European, veç forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile, ka në qendër të punës së tij edhe rritjen në mënyrë të vazhdueshme të kapaciteteve të saj, si një nga partnerët më të rëndësishëm në ecurinë e reformave të integritit. Për këtë qëllim gjatë zhvillimit të tetë raundeve të deritanishme të Shkollës së Integritit European, i është kushtuar rëndësi e veçantë përzgjedhjes së aplikantëve të spikatur nga shoqëria civile, duke trajnuar në total 70 përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile.

❖ **Bashkëpunimi i KKIE me median**

Bashkëpunimi me median dhe rritja në mënyrë të vazhdueshme të kapaciteteve të saj, kanë qënë dhe vazhdojnë të jenë ndër përparësitë e punës së KKIE. Ligji 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian”, i ndryshuar, garanton

për përfaqësuesit e medias, statusin e të ftuarit në takimet e Këshillit. Më datë 26.05.2023, në faqen elektronike të Kuvendit u publikua: “Thirrja për aplikimin e mediave për anëtarësim në Këshillin Kombëtar të Integritit Europian”. Pas përfundimit të afatit parashikuar në thirrjen përkatëse, në datë 15.06.2023, rezultuan 3 aplikime nga përfaqësuesit e medias të cilat u kualifikuan dhe morën statusin e të ftuarit për mandatin e ri.

Këshilli Kombëtar i Integritit Europian, veç forcimit të bashkëpunimit me median, ka në qendër të punës së tij edhe rritjen në mënyrë të vazhdueshme të kapaciteteve të saj, si një nga partnerët më të rëndësishëm në ecurinë e suksesshme të reformave të integritit. Për këtë qëllim gjatë zhvillimit të tetë raundeve të deritanishme të Shkollës së Integritit Europian, i është kushtuar rëndësi e veçantë përzgjedhjes së aplikantëve të spikatur nga përfaqësuesit e medias.



❖ **Bashkëpunimi i KKIE me grupet e interesit**

Ligji nr. 19/2023, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Europian”, solli një risi në kuadër të gjithëpërfshirjes dhe krijimit të hapësirave gjithnjë e më të mëdha për aktorë të rinj të interesit. Neni 4, pika 2 e ligjit zgjeroi rrethin e aktorëve me statusin e të ftuarit në KKIE, me të drejtë aplikimi në bazë të fushës së përgjegjësisë, për organizatat e biznesit, dhomat e tregtisë dhe

sindikatat. Më datë 26.05.2023, në faqen elektronike të Kuvendit u publikua “Thirrja për aplikimin e organizatave të biznesit, dhomave të tregtisë dhe sindikatave për anëtarësim në Këshillin Kombëtar të Integritit Europian”. Pas përfundimit të afatit parashikuar në thirrjen respektive, në datë 15.06.2023, rezultuan 6 aplikime nga grupet e interesit, të cilat u kualifikuan dhe morën statusin e të ftuarit për mandatin e ri.

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ndryshimet ligjore në ligjin 15/2025 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, sollën ndryshime jo vetëm në përbërjen por dhe kompetencat e Këshillit Kombëtar të Integritit Europian si dhe disa përgjegjësi të reja në lidhje me funksionalitetin e kësaj strukture. Këshilli Kombëtar të Integritit Europian vazhdon të mbetet organi më lartë këshillimor kombëtar për diskutimin e çështjeve të integritit evropian por dhe njëkohësisht një platformë mbarëkombëtare dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë grupet e interesit. Me rëndësi është dhe zgjerimi i përbërjes së Këshillit Kombëtar të Integritit Europian, me titullarët e KLGJ, KLP, ILD dhe SPAK por edhe të gjithë aktorëve të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, të cilët iu përgjigjen thirrjes për aplikim për çdo grup-kapituj duke synuar kështu rritjen e gjithëpërfshirjen por dhe nivelit të ekspertizës për çështjet që diskutohen në KKIE.

Përbërja e KKIE është bërë edhe më gjithëpërfshirëse duke krijuar hapësira gjithnjë e më të mëdha për grupet e interesit. Sa i përket vitit 2024, KKIE do të përqendrojë veprimtarinë në këto drejtime kryesore:

- Nxitjen e bashkëpunimit midis forcave politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura, shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- Monitorimin e zbatimit të detyrimeve, gjatë procesit të negociatave me Bashkimin Evropian;
- Monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian 2023 dhe nënkomiteteve BE-Shqipëri;

- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e kapaciteteve të të gjithë grupeve të interesit në lidhje me procesin e integrit;
- Informimin korrekt të publikut mbi monitorimin e detyrimeve për anëtarësim.

KKIE e konsideron komunikimin gjithëpërfshirës të procesit të integritit europian si sfidën kryesore përgjatë vitit në vijim. Në këtë drejtim dhe me qëllim rritjen e transparencës, KKIE do vazhdojë të transmetojë direkt të gjitha takimet dhe diskutimet që do të mbahen gjatë vitit 2024, përveç rastit kur ky Këshill do të vendosi ndryshe.

Gjithashtu në këtë kuadër, do të vazhdojë publikimi i materialeve informative rreth aktiviteteve të KKIE, në këndin elektronik të posaçëm për KKIE, të faqes së Kuvendit dhe rrjetin social Facebook.

Nxitja dhe lehtësimi i dialogut publik mbi zbatimin dhe cilësinë e reformave si dhe informimi korrekt i shoqërisë mbi sfidat dhe përfitimet në procesin e integritit janë vendimtare në forcimin e konsensusit mbarë shoqëror. Për këtë arsye do të rriten përpjekjet për bashkëbisedim me të gjithë grupet e interesit, përmes organizimit të takimeve informuese, forumeve dhe tryezave të rumbullakëta të përqendruara në kapituj dhe politika prioritare të legjislacionit të BE, duke inkurajuar debatin konstruktiv mbi qasjen efektive ndaj detyrimeve të anëtarësimit.

KKIE, mbështetur në detyrimin ligjor, do të vijojë mbikqyrjen e ecurisë së procesit të integritit europian dhe përmbushjes së detyrimeve të anëtarësimit. Një vëmendje të veçantë gjatë këtij viti do t'i kushtohet monitorimit të procesit të negociatave dhe takimeve me strukturën përgjegjëse për negociatat.

Edhe gjatë vitit 2024, mbështetur në qëllimin e rikonfirmuar gjatë viteve, për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative për çështjet e integritit europian, KKIE do të organizojë Shkollën e Integritit Europian, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë. Përcaktimi i tematikave që do të trajtohen si dhe numri i përfaqësuesve që do të trajnohen, gjithnjë në përputhje me stadin që po kalon vendi, janë elementë që do të rivlerësohen në organizimin e SHIE.

ANEKS

PROGRAMI I PUNËS VITI 2024

Lloji i aktivitetit	Vendi	Pjesëmarrësit	Periudha
Takim rajonal ndërgjegjësues mbi “Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe ndikimi i tij në përsheptimin e reformave të shtetit të së drejtës”.	Tiranë	MD, OSHC, përfaqësues të medias, akademisë, ambasada të vendeve të anëtare të BE dhe rajonit, etj,	12 Mars
Takime ndërgjegjësues me OSHC mbrojtjen e Konsumatorit	Tiranë	MEIK, MBZHR, MSHMS, MMT, OSHC, përfaqësues të medias, akademisë, ambasada të vendeve të anëtare të BE etj,	15 Mars
Takime ndërgjegjësuese me OSHC mbi tematika të ndryshme si: mbi fushën tregut të përbashkët rajonal, ndryshimet klimaterike, energjisë, procesin e Berlinit, rolin e KKIE dhe Kuvendit në procesin e integrimit, etj.	Tiranë dhe qytete të tjera	Anëtarët e KKIE, OSHC, institucionet sipas fushës së përgjegjesisë etj	Mars-Dhjetor
Takim mbi “Ecuria e procesit të negociatave, perspektiva e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European”.	Tiranë	Anëtarët e KKIE, Kryenegociatorja, MEPJ, MD, MB, MF, KLSH, INSTAT, APP, etj, të ftuar nga Delegacioni i BE dhe ambasadat e vendeve anëtare të BE në Shqipëri.	Maj - Dhjetor
Takime mbi monitorimin e raportit screening për Grup Kapitullin e parë	Tiranë	Anëtarët e KKIE, Kryenegociatorja, MEPJ, MD, MB, PP, APP, MF, të ftuar nga	Mars – Dhjetor

<p>(cluster I) / sipas kapitujve dhe mbi udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës dhe reformën në administratë publike (Kap 23, 24, Reforma në Administratën publike, Funksionimi i institucioneve demokratike).</p>		<p>Delegacioni i BE dhe ambasadat e vendeve anëtare të BE në Shqipëri etj.</p>	
<p>Shkolla e Integritit European 2024.</p>	<p>Tiranë</p>	<p>35 – 40 pjesëmarrës nga të gjithë kategoritë e aktorëve të përfshirë në procesin e integritit european të vendit.</p>	<p>Tetor/Nëntor</p>